

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Fall 11-2019

PAPUNËSIA NË KOSOVË (RAST STUDIMI QYTETI I LIPJANIT NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME)

Egzon Stullca

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Business Commons](#)

Recommended Citation

Stullca, Egzon, "PAPUNËSIA NË KOSOVË (RAST STUDIMI QYTETI I LIPJANIT NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME)" (2019). *Theses and Dissertations*. 1780.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/1780>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



Koleji UBT

Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

**PAPUNËSIA NË KOSOVË
(RAST STUDIMI QYTETI I LIPJANIT NDËRMARRJET E VOGLA
DHE TË MESME)**

Shkalla Bachelor

Egzon Stullca

Nëntor / 2019

Prishtinë



Kolegji UBT

Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Punim Diplome

Viti akademik 2014-2015

Egzon Stullca

PAPUNËSIA NË KOSOVË

**(RAST STUDIMI QYTETI I LIPJANIT NDËRMARRJET E VOGLA
DHE TË MESME)**

Mentor: Dr. Sc. Mirjeta Domniku

Nëntor / 2019

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Nga aspekti ekonomik papunësia do të thotë mos shfrytësimi i forcës prodhuese apo thënë ndryshe të popullsisë aktive në krijimin e të mirave materiale. Thellësia e krizës në Kosovë dhe nëse mundë ti quajmë tendencat dramatike të papunësisë në mënyrë të pa evitueshme kanë pasur ndikimn e tyre në shkallen ekonomike të vendit. Një hyrje e shkurtër rreth papunësisë në bazë të disa shembujve që kemi marrë më poshtë duke tregu se ku është e theksuar papunësia më shumë te gjinija femrore apo ajo mashkullore, njohjen e konceptit të papunësisë, llojet e papunësisë, problemet e ndryshme të papunësisë dhe me shembuj dhe të dhëna të ilustruara do të tregojmë mënyren se si e ushtrojn veprimtarinë e tyre bizneset e tona të sektorit privat në lidhje me deklarin e punëtoveve atu ku edhe qëndron pesha e këtij punimi. Ky punim përfshin përkufizimin duke I dhënë një kuptim të gjerë termit lidhur me “papunësinë”. Për shtjellimin apo studimin e këtij punimi kureshtje të madhe më ka zgju përvojat më të hershme si student në kuader të shkollimit tim në nivel universitar ku edhe kamë punuar në sektor privat dhe duke pa se si shkojnë gjërat në shtetin tonë kam shprehë kureshtjen time që të punojë në lidhje me shtjellimin e problemeve në sektorin privat që nuk deklarohen punëtove në menyrë reale ata të cilët janë duke punuar ku pjesa dërmuese nuk kanë të lidhura as kontrata pune. Tek punimi im te rasti studimit të dhënat që janë mbledhur kanë ardhë në bazë të pyetsorit të drejtpërdrejt me pronar të bizneseve në sektorin privat të qytetit tim si dhe së fundmi me kompanin edhe në të cilën punoj. Gjatë punimit kam përdorur të dhëna primare,sekondare,statistikore. Kosova ka gjitha kapacitet e duhura për ta pasur një ekonomi të zhvilluar, ka armën kryesore që do të thotë ka pjes të konsiderueshme të të rinjëve me moshë të cilet kanë të drejt pune, më tej do te shohim se sa ndikon sektori privat në këto të dhëna të cilat shfaqen nga ASK-ja.

Fjalët kyçe: Papunësia në Kosovë, ndikimi sektorit privat, raporti inflacion papunësi

MIRËNJOHJE DHE FALENDËRIME

Një falendërim të singertë i dedikohet mentores time Dr.Sc. Mirjeta Domniku për përkrahjen dhe mbështetjen morale, për këshillat e vyera dhe gatishmerinë e saj ndaj meje.

Falënderime u shpreh edhe kolegëve të mi te Departamentit me të cilët kamë gjetur mbështetje gjithmonë, si dhe të gjithë miqtë e largët dhe të afërt.

Falendërim nga zemra edhe për familjen time, për durimin dhe mirëkuptimin që kanë dëshmuar sidomos në këto kohët e fundit.

Gjithshtu, e falendëroj menaxhmentin e kompanive përkatëse që më lejuan dhe më ndihmuan të aplikoj pjesën hulumtuese të studimit.

Për fund të gjithë suksesin i'a dedikoj personit tim të zemres Babait i cili nuk është me ne tash e 17 vite, mirpo i gjithë suksezi im është për të ai është motiv të mësoj dhe të punoj që ai të mburret me mua.

Mirënjohës gjithmonë

Egzon Stullca

PËRMBAJTJA

LISTA E FIGURAVE	V
LISTA E TABELAVE	V
LISTA E GRAFIKAVE	V
FJALORI I TERMAVE	VI
1 HYRJE	1
2 SHQYRTIMI I LITERATURËS (HISTORIKU)	2
2.1 Definicione lidhur me papunësinë	2
2.2 Llojet e papunësisë.....	5
2.2.1 Papunësia e fërkimit (frikcionale).....	5
2.2.2 Papunësia strukturore	6
2.2.3 Papunësia ciklike	7
2.2.4 Papunësia sezonale	8
2.3 Shkaqet e papunësisë	8
2.4 Të dhënat e Agjencisë Statistike të Kosovës për papunësinë (ASK)	10
2.5 Ndikimi i Privatizimit në Papunësi.....	14
2.6 Raporti mes papunësisë dhe inflacionit	14
2.7 Paga mujore neto.....	15
2.8 Punësimi sipas gjinisë	16
2.9 Personat joaktivë.....	17
3 DEKLARIMI I PROBLEMIT	19
4 METODOLGJIA	20
5 REZULTATET	22
5.1 Historiku I Kompanive (Resultati A).....	22
5.2 Punësimi i paqëndrueshëm (Resultati B).....	34

6	DISKUTIME DHE PËRFUNDIME.....	38
6.1	Rekomandimet.....	39
7	REFERENCAT	40
8	APPENDIXES	41

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Klasifikimi i fuqisë punëtore në Anketën e Fuqisë Punëtore të BE.....	4
Figura 2. Pamja e papunësisë fleksibile dhe jofleksibile.....	9
Figura 3. Paga mujore neto për punonjësit sipas gjinisë	16

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Klasifikimi i tregut të punës për popullsinë e Kosovës në bazë të raportit AFP-së	13
Tabela 2. Paraqitja tabelare e numrit të punëtoreve në kompanitë përkatëse.....	24
Tabela 3. Punësimi i paqëndrueshëm sipas gjinisë.....	34
Tabela 4. Punësimi i paqëndrueshëm sipas profesionit dhe gjinisë	35
Tabela 5. Punësimi i paqëndrueshëm sipas nivelit arsimor dhe gjinisë	36

LISTA E GRAFIKAVE

Grafikoni 1. Papunësia sipas gjinisë.....	17
Grafikoni 2. Popullsia jo aktive.....	18
Grafikoni 3. Paraqitja e profileve të operimit të kompanive	25
Grafikoni 4. Paraqitja vjetore e operimit në tregun Kosovar të Kompanive përkatëse.....	26
Grafikoni 5. Paraqitja e operimit në tregun Kosovar të Kompanive përkatëse.....	27
Grafikoni 6. Moshja e punëtoreve të interesuar për punë dhe kuadri tyre	28
Grafikoni 7. Punëtori është Kosto apo Burim që krijon vlerë	29
Grafikoni 8. Numri i punëtoreve të lidhur me kontrata pune	30
Grafikoni 9. Selektimi i punëtoreve	31
Grafikoni 10. Gjinja e punëtoreve	32
Grafikoni 11. Kualifikim i punëtorve.....	33

FJALORI I TERMAVE

AFP - Anketa e Fuqisë Punëtore

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës

BE - Bashkimi Evropian

NEET - Të rinj që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollën apo trajnim

1 HYRJE

Në këtë kapitull do të paraqitet një përmbledhje në pika të shkurta për punimin dhe qëllimin e këtij punimi.

Në këtë temë do të shqyrtojë problemin e papunësisë në Kosovë shkaqet, faktorët që ndikojnë në të si dhe sektorët ku marrin pjesë më shumë gjinija femrore dhe ajo mashkullore, pagat dhe te të cilët është e theksuar më shumë. Papunësia në Kosovë vazhdon të mbetet në një nivel tejet të lartë, kur e dimë që Kosova ka 1.739.825 banorë bazuar në matjen e popullësisë së fundmi dhe në bazë të Agjencisë së Statistikave të Kosovës rezultatet janë me 30.7 % papunësi. Arsyeja pse më ka shtyer ta punoj këtë punim është që të hulumtoj se kjo shkallë e papunësisë e cila është mjaftë e madhe, a është si pasojë e mos deklarimit të punëtorve të lidhur me kontrata pune nëpër sektorë privat dukuri e cila është mjaft e përhapur te ne, ikja e rinisë e cila konsiderohet si e ardhmja e çdo vendi po ashtu edhe e Kosovës, apo mungesa e fuqisë punëtore si dhe shumë probleme të tjera të cilat me grumbullimin dhe përpunimin e materialit në vazhdim do të mundohem që të preki gjitha temat nga pak. Ku si rast studimi për deklarim të problemit do të fokusohem në qytetin e Lipjanit, ndërsa në pjesen e dytë do të paraqes rezultate në nivel të Kosovës.

Ky punim do të mbështet në këto pika :

Njohja me konceptin e papunësisë

Matja e papunësisë

Llojet e papunësisë

Ndikimi i sektorit privat në papunësi

Pagat neto duke u bazuar në gjini

Papunësia dhe inflacioni

Problemet e ndryshme të papunësisë

2 SHQYRTIMI I LITERATURËS (HISTORIKU)

Ky kapitull është ndarë në disa pjesë që ndihmojnë për të krijuar kuadrin teorik të të gjithë punimit në mënyrë të qartë dhe logjike, ku është shqyrtuar literatura që përfshinë investimet e huaja direkte, asistencat e jashme, analizën e tij me një numër të madh definimesh, kuptimesh, analiza, shkrime etj.

2.1 Definicione lidhur me papunësinë

Papunësia njihet edhe si “sëmundje e rëndë” makroekonomike kur bëhet rritja e treguesve të papunësisë konsiderohet një simptomë e fazës së recesionit ekonomik po ashtu është barrë e rëndë financiare për qeverinë. Të papunët përveç se janë barrë financiare për qeverinë ata mund të jepen pas dukurive negative shoqërore si shembull mundë të jetë rritja e kriminalitetit në shkallë vendi, vjedhje, grabitje e të tjera.

Matja e papunësisë bëhet duke marrë parasyshë popullësinë totale nën moshën 65 vjeç dhe ndahet në ata që janë aktiv dhe ata që janë aktiv (forcat e punës) që përfshinë të punësuar dhe të papunë.

Të punësuar konsiderohen personat që kryejnë një punë të pagueshme dhe ata që janë të zënë me punë, por mund të mungojnë përkohësisht nga puna për shkak të sëmundjes, grevës, shërbimit ushtarak, pushimit vjetor, lehonisë ose për shkaqë të tjera.

Të pa punë konsiderohen personat që nuk janë në punë, por janë të aftë për punë dhe në mënyrë aktive kërkojnë punë. Thënë më saktë, persona të papunë janë ata që mënyrë aktive nuk janë në marrëdhënie pune dhe bëjnë përpjekje aktive për të gjetur punë, që janë të pushuar nga puna dhe presin të thirren përsëri në punën e mëparshme dhe që presin të punësohen në ndonjë vend të ri pune, pra të punësohen për herë të parë.

Jashtë forcës punëtore duke u bazu nga dy përkufizimet më lartë nuk është vështirë të konstatohet se numri i të punësuarve, plus numri i të papunëve përbëjnë numrin e forcës punëtore në një vend përkatës. Ndërkaq të gjithë të tjerët që janë në moshën e punës, e që nuk janë në punë, sic janë: nxënësit, studentët, pensionistët, të sëmurët e rëndë, ata për mirëmbajtjen e shtëpisë dhe rritjen e femijëve dhe të tjerët që nuk kërkojnë punë për arsye të ndryshme, pra të gjithë ata që për këto arsye largohen nga tregu i punës, nuk përfshihen në forcën punëtore, por konsiderohen jashtë forcës punëtore. Papunësia shprehet ndërmjetë normës së papunësisë, e cila paraqet indikacion alarmues për ecuritë makroekonomike. Norma e papunësisë paraqet raportin ndërmjet numrit të të papunësuarve dhe forcës punëtore që shprehur matematikisht do të jetë:

$$Np1 = \frac{\text{Numri i tw papunësuarve}}{\text{Forca punëtore (nukë përfshihet forca ushtarake)}} \times 100 = \frac{Np}{Fp} \times 100 \dots$$

Kur jemi te matja e papunësië duhet të japim edhe ligjin e Okuni-it, ku sipas këtijë ligji, për çdo 2.0% të rënies së GDP aktuale, në krahasim me GNP potenciale, norma e papunësië rritet me 1.0%. Për shembull, në qoftë se GNP potencial është 100.0% dhe GNP aktual bie në masën 98.0% dhe norma e papunësisë është 5.0% atëher norma e papunësisë do të rritet nga 5.0% ne 6.0% pra për 1.0%.

Person i moshës 15 vjeç e më shumë që jeton në një ekonomi familjare private

Personi ka bërë ndonjë punë për pagesë ose fitim gjatë javës referente

Personi nuk ka punuar por ka pasur një punë ose biznes prej të cilit ka munguar në javën referente

Punëtor familjar i papaguar

Person i moshës 15-74 vjeç, i cili nuk ka kërkuar punësim sepse puna e cila do të fillojë brenda 3 muajve tanimë ishte gjetur

Person i moshës 15-74 vjeç, që kërkonte punësim




Figura 1. Klasifikimi i fuqisë punëtore në Anketën e Fuqisë Punëtore të BE

(Ask, 2019)

2.2 Llojet e papunësisë

Në shqyrtimet e mëtejshme rreth papunësisë do të përqendrohemi në llojet e saj, duke i dhënë karakteristikat e tyre. Në vazhdim do t'i analizojmë llojet më karakteristike të papunësisë. Duke analizuar tregun e tashëm të punës, në literaturën aktuale ekonomike hasim në këto lloje të papunësisë.

2.2.1 Papunësia e fërkimit (friksionale)

Papunësia friksionale është papunësia e përkohshme dhe e pashmangshme. Papunësia friksionale ekziston kur ka mospërputhje midis kërkesës dhe ofertës për punë. Kjo formë papunësie shkaktohet sepse njerëzit lëvizin ose ndryshojnë profesionin e tyre. Shumë punëtorë mund ta lënë punën dhe të kërkojnë një punë tjetër për arsye financiare dhe/ose ambicie personale. Kalimi nga një punë në një tjetër mund të bëhet për shkak të pagës më të lartë, për të rritur pozitën profesionale, për të lëvizur nga një rajon i varfër në një rajon më të zhvilluar. Këtu përfshihet gjithashtu edhe mos angazhimi i menjëhershëm i studentëve në punë pas përfundimit të studimeve. Në procesin e lëvizjes nga një punë në një tjetër, një person mund të humbasë disa ditë apo javë, pa pasoja të rënda personale ose shoqërore. Kjo mund të ndodhë për shkak të mungesës së njohurive nga ana e punëdhënësve në lidhje me disponueshmërinë e punëtorëve ose për shkak të mungesës së njohurive nga ana e punëtorëve se punësimi është në dispozicion në një vend të caktuar. Pra, kemi të bëjmë me periudha të shkurtra të përvojave të papunësisë nga njerëzit që lëvizin nga një vend pune në një tjetër apo në tregun e punës.

Tri gjëra e dallojnë papunësinë e fërkimit nga llojet e tjera të papunësisë. Së pari, ekzistojnë mjaft punë për ata që janë friksionalisht të papunë, pra, ka kërkesë të mjaftueshme për punë. Së dyti, ata individë, të cilët janë të papunë në mënyrë friksionale, zotërojnë aftësitë e nevojshme për punët në dispozicion. Së treti, periudha e kërkimit të punës do të jetë relativisht e shkurtër. Në këto kushte, papunësia e fërkimit i ngjan një loje të karrigeve

muzikore, në të cilat ka mjaft karrige me madhësi të barabarta për të gjithë lojtarët dhe ata vallëzojnë rreth tyre vetëm për një periudhë të shkurtër kohe. (Schiler 1997). Askush nuk e di me siguri në çfarë mase është friksional problemi i papunësisë. Shumica e ekonomistëve pajtohen që papunësia e fërkimit është përgjegjëse e vetme për një shkallë papunësie prej 2-3 për qind. Prandaj, përkufizimi ynë i punësimit të plotë duhet të lejojë të paktën këtë lloj papunësie, sepse papunësia friksionale është çdoherë prezente në një ekonomi dhe është një papunësi e vullnetshme. (Zeqiri, 2016)

2.2.2 Papunësia strukturore

Papunësia strukturore shkaktohet nga përshtatjet strukturore të ekonomisë. Këto përshtatje sjellin ndryshime në kërkesën e tregut për mallra dhe shërbime, duke shkaktuar ndryshime në kërkesën për fuqi punëtore. Papunësia strukturore ndodh kur numri i punëve në dispozicion në tregun e punës është i pamjaftueshëm për të punuar kush do që do të dëshironte të punonte. Ajo shkaktohet nga mospërputhja midis aftësive të punëkërkuesve dhe kërkesës së punëve në dispozicion. Kjo, pra, është papunësia që krijohet prej përplasjes së kërkesës dhe ofertës për punë. Kërkesa për një lloj pune është rritur në një kohë që kërkesa për një lloj pune tjetër është ulur pa ndryshim në ofertë. Për shumë punë kërkues, periudha ndërmjet punëve mund të zvarritet për muaj të tërë apo edhe vite, sepse ata nuk kanë aftësitë e nevojshme që kërkojnë punëdhënësit. Shumica e papunësisë teknologjike mund të llogaritet si papunësi strukturore, çka do të thotë që më pak punëtorë do të nevojiten për të prodhuar nivelin e njëjtë të prodhimit për çdo vit. Papunësia strukturore është e ngjashme me një lojë të karrigeve muzikore në të cilën ka mjaftë karrige për të gjithë, por disa prej tyre janë shumë të vogla për t'u ulur në to. (Schiler 1997) Kjo formë paraqet një shqetësim më serioz se papunësia e fërkimit dhe është e papajtueshme me çdo ide të punësimit të plotë. Nga përkufizimi i kësaj forme të papunësisë kuptojmë që kjo papunësi është një papunësi e detyrueshme, e cila gjithashtu gjendet thuajse në çdo ekonomi dhe një përqindje e vogël e kësaj papunësie lejohet në punësimin e plotë nga ekonomistët. (Zeqiri, 2016)

2.2.3 Papunësia ciklike

Çdo ekonomi ka uljet dhe ngritjet e saj, të cilat njihen si ciklet e biznesit. Papunësia ciklike është ajo papunësi, e cila shkaktohet nga ndryshimi në fazat e ciklit të biznesit. Gjatë një rënieje, shkalla e papunësisë arrin 8,9 apo 10%. Gjatë Depresionit të Madh (1929 – 1933), shkalla zyrtare e papunësisë u rrit në 25%, duke dhënë, kështu, një pasqyrë të qartë të papunësisë. Nëse lejojmë një shkallë të caktuar të papunësisë friksionale dhe strukturore, çdo gjë mbi shkallën e këtyre dy llojeve të papunësisë do të jetë papunësia ciklike. (*Slavin 1999*)

Le të themi se shkalla e papunësisë friksionale dhe strukturore është 5%, nëse norma aktuale e papunësisë është 7,7%, norma ciklike e papunësisë është 2,7 %. Ekonomistët liberalë këmbëngulin se mund të arrijmë realisht shkallën e papunësisë deri në 4% në punësimin e plotë, ndërsa ekonomistët konservatorë konsiderojnë 6%, normën më të ulët të arritshme. Papunësia ciklike është një nga llojet më të rëndësishme dhe më të analizuara të papunësisë, me pasoja më të mëdha dhe gjithnjë më e pritshme. Edhe kjo papunësi, gjithashtu, i ngjan lojës së karrigeve muzikore, në të cilën numri i karrigeve është gjithmonë më i ulët se numri i lojtarëve. (*Schiler 1997*) Kjo do të thotë se kjo papunësi është pasojë e mungesës së vendeve të lira të punës apo e një niveli të pamjaftueshëm të kërkesës agregate, që në esencë paraqet një papunësi të detyruar apo të pavullnetshme. Depresioni i Madh është shembulli më i mirë i papunësisë ciklike. Rritja drastike e shkallës së papunësisë, që filloi në vitin 1930, nuk ishte për shkak të ndonjë rritjeje në —fërkime apo rënieje të papritur në aftësitë e punonjësve. Në vend të kësaj, normat e larta të papunësisë që vazhduan për një dekadë ishin për shkak të një rënieje të papritur të kërkesës së tregut për mallra dhe shërbime. (*Zeqiri, 2016*)

2.2.4 Papunësia sezonale

Në çdo kohë, me qindra mijëra njerëz mund të jenë të papunë për shkak se puna e tyre është sezonale. Ajo është e lidhur me natyrën e produkteve të prodhuara që reflektohen në sasinë e tyre. Përgjithësisht, ky lloj i papunësisë shkaktohet nga dy faktorë: i pari, si rezultat i mospërputhjes së periudhës së prodhimit me periudhën e punës dhe, i dyti, nga faktorët kohorë sezonalë. (Naqellari 2007) Papunësia sezonale është e pranishme në degët e industrisë së ndërtimit, në bujqësi, në shërbime, në turizëm, etj., sepse në këto degë karakteri stinor i prodhimit dhe kushtet e motit parapërcaktojnë edhe kërkesën për punë. Papunësia sezonale është një lloj i papunësisë së vullnetshme, pa pasojat e papunësisë ciklike ose strukturore dhe është më e ulët se papunësia friksionale dhe strukturore. (Zeqiri, 2016)

2.3 Shkaqet e papunësisë

Ekonomistët sikurse edhe profilet e tjera, kanë kundërthënie ndërmjet vete për ndonjë problem, por asnjë çështje tjetër ekonomike nuk ka nixtur kundërthënie sa shkaqet e papunësisë në kushtet e ekonomisë së tregut.

Më herët është theksuar se në ekonominë e tregut çmimi rritet apo ulët për të përcaktuar ekuilibrin në treg, ku me çmimin e ekuilibruar të tregut pajtohen si shitësit (prodhuesit) ashtu edhe blerësit (konsumatorët). Mirëpo, kjo nuk ndodh në tregun e punës. Tregu i punës ka veçorit e veta, në krahasim me tregun e mallrave apo të kapitalit. P.sh spitalet kërkojnë infermiere apo mjekë, por nuk mund t'i gjejnë, me që oferta për këtë profil kuadrosh është e vogël, apo mungon fare. Ndërkohë mijëra punëtorë të minierave të thëngjillit, të hekurit dëshirojnë të punojnë me pagën ekzistuese në treg, por nuk mund të gjejnë punë, pasi për këto profile nuk ka kërkesë nga ndërmarrjet përkatëse, në një anë, kurse në të njejtën kohë oferta është e madhe, në anën tjetër.

Ekonomistët për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje ju kthehën shqyrtimeve mikroekonomike të problemeve të papunësisë. Në këtë aspekt nuk kemi ndonjë teori universale në teorinë

ekonomike. Lidhur më këtë, në kuadër të ekonomistëve mendimin e kemi të ndarë në dypikëpamje: Sipar njerës pikëpamje papunësia rezulton nga fakti se pagat nuk janë fleksibile dhe në këto kushte papunësia ka karakter të vullnetshëm. Tash të dyja këto pikëpamje po i ilustruon në grafikun e mëposhtëm. (Zeqiri, 2016)




Figura 2. Pamja e papunësisë fleksibile dhe jofleksibile

(Zeqiri, 2016)

Papunësia e vullnetshme - Ashtu si shihet në grafik, kurba e kërkesës DD dhe kurba e ofertës për punë në kushtet e tregut konkurrencial priten në pikën E, e cila përfaqëson ekulibrin e tregut me nivelin e pagës \bar{W} . Në ekulibrin e tregut konkurrencial, dmth me nivelin e pagës (mëditjes) \bar{W} , ndërmarrjet janë të gatshme të pranojnë në punë të gjithë punëtorët e kualifikuar, që dëshirojnë të punojnë me pagën e tregut. Me këtë rast numri i të punësuarve jepet me segmentin AE. Ndërkaq, në segmentin E-F paraqitet pjesa e forcës punëtore, e cila dëshiron të punojë, por vetëm me paga më të larta se ato të tregut. Andaj, të papunët, të cilët nuk pranojnë të punojnë me pagën e dhënë të tregut, por me pagë më të lartë, që në grafikë janë paraqitur në segmentin E-F, quhet papunësi e vullnetshme. Arsyet për mospranimin e pagës së dhënë të tregut nga të papunësarit mund të jenë të ndryshme, ndoshta kërkojnë aktivitete të tjera, për të vazhduar kualifikimin (shkollimin). Por, sido që të jetë, lidhur me këtë mundë të konsiderohet se në kushtet kur ekziston paga plotësisht fleksibile nuk mund të ketë papunësi të detyrueshme.

Papunësia e detyrueshme -Ky lloj i papunësisë paraqitet atëherë kur në kushtet e tregut konkurrencial pagat janë jofleksibile. Kejnisi në qasjet e tij, në teorinë e zhvillimit ekonomik, ndër të tjera ka shpjeguar se papunësia ciklike ndodhë sepse pagat janë fleksibile. Këtë situatë më së miri mund ta kuptojmë nese e analizojmë grafikun më lartë. Në qoftë se pagat janë të larta, në këtë rast paraqitet situatë kur kemi më shumë punëtorë të kualifikuar që kerkojnë punë sesa që ndermarrjet kanë vende të lira pune, apo kerkojnë punëtorë. Pra, me pagën më të lartë të tregut, pra E' , ka më shumë punëtorë të kualifikuar që dëshirojnë të punojnë, sesa që janë vendet e lira të punës. Punëtorët që janë të gatshëm të punojnë në nivelin e pagës E gjenden në pikën G, që gjendet në kurbën e ofertës. Ndërkaq ndermarrjet janë të gatshme të angazhojnë vetëm H puntëorë, sic e tregon kurba e kërkesës. Kjo na shpie në konstatimin se kur paga e tregut E' është më e madhe se paga e ekuilibrit E , atëherë kemi tepricë punëtorësh. Në grafikun më lart figura e dytë segmenti me vija të ndërprera H-G tregon numrin e të papunëve, përkatësisht papunësinë e detyrueshme, që do të thotë se ato paraqesin punëtorët e kualifikuar që dëshirojnë të punojnë me paga mbizoteruese, por nuk mund të gjejnë punë. Tash këta punëtorë më nuk janë të papunë “vullnetarë” siç e patëm situatën me rastin e parë. Edhe në tregun e punës, kur kemi tepricë punëtorësh, ndermarrjet do të kenë kërkesë më seleksionuese e më migruese dhe nga mesi i tyre do të zgjedhin punëtorët më të kualifikuar dhe më me përvojë. Në të kundërtën, kur paga e tregut është më e ulët se paga e ekulibrit, do të kemi mungesë të punëtorëve dhe ndermarrjet do të kerkojnë më shumë punëtorë nëpërmjet shpalljeve, konkurseve.

2.4 Të dhënat e Agjencisë Statistikore të Kosovës për papunësinë (ASK)

Kosova ka 1.739.825 banorë bazuar në matjen e popullësis së fundmi dhe në bazë të Agjencisë të Statistikave të Kosovës ka dal me 30.7 % papunësi, si dhe ndër rezultatet kryesore të AFP-së, siç paraqitet në grafikun dhe elaborohet më tej në këtë raport.

Pothuajse dy të tretat e popullsisë së Kosovës është në moshë pune (15-64 vjeç). Pritet që popullsia në moshë pune të rritet shpejt gjatë dekadës së ardhshme pasi Kosova është ndër

vendet me popullsinë më të re në Evropë. Nga popullsia në moshë pune, 58.0 % nuk janë ekonomikisht aktivë, që do të thotë se ata nuk janë të punësuar dhe nuk kanë qenë aktivë në kërkim të punësimit gjatë katër javëve të kaluara dhe/ose nuk janë të gatshëm të fillojnë punë brenda dy javësh. Nga 42.0 % e popullsisë, që është ekonomikisht aktive, 30.7 % (154,180 persona) janë të papunë. Kjo do të thotë se 58.0 % (501,731) e personave ekonomikisht aktivë janë të punësuar, duke krijuar një raport punësimi ndaj popullsisë (shkalla e punësimit) prej 29.1 %. Ndërsa 58.0 % e popullsisë në moshë pune, që është joaktive.


Ekzistojnë dallime të mëdha gjinore në tërë tregun e punës. Një në pesë (19.3 %) femra në moshë pune janë aktive në tregun e punës, krahasuar me rreth tri te pestat (64.7 %) e meshkujve në moshë pune. Në mesin e personave në fuqinë punëtore, papunësia është më e lartë për femrat se sa për meshkujt (34.8 % krahasuar me 29.5 %). Shkalla e punësimit në mesin e femrave në moshë pune është vetëm 12.6 %, krahasuar me 45.6 % për meshkujt. Kjo shkallë shumë e ulët e papunësisë te femrat rrjedh nga kombinimi i pjesëmarrjes shumë të ulët në fuqinë punëtore dhe papunësisë së lartë. Femrat ishin të punësuar kryesisht në sektorët e arsimit, të tregtisë dhe të shëndetësisë (54.5 % e femrave të punësuar). Meshkujt ishin kryesisht të punësuar në sektorët e tregtisë, ndërtimtarisë dhe prodhimit (duke punësuar 44.1 % të meshkujve të punësuar). Papunësia tek të rinjtë është shumë e lartë në Kosovë. Në tremujorin e tretë të vitit 2018, të rinjtë në Kosovë kishin gjasa dy herë më shumë të jenë të papunë krahasuar me të rriturit. Në mesin e personave të moshës 15-24 vjeçare dhe në fuqinë punëtore, 55.0 % ishin të papunë. Papunësia është më e lartë te femrat e reja (62.5 %) se te të rinjtë meshkuj (51.8%).

Pothuaj një e treta (30.2 %) e personave të moshës 15 deri 24 vjeçare në Kosovë nuk ishin në shkollim, punësim apo trajnim (NEET). Kjo shifër është 29.6 % për femrat e reja krahasuar me 30.8 % për të rinjtë meshkuj. Pjesa më e madhe e atyre që janë të punësuar raportojnë të punojnë me orar të plotë. Ndërsa 95.3 % e të intervistuarve raportuan se punojnë me orar të plotë në punën e tyre kryesore. Arsytet e të punuarit me orar të pjesshëm dallojnë midis dy gjinive, pasi gratë, duke marrë përsipër më shumë rolin e kujdesit brenda familjes, reduktojnë orët në dispozicion për punësim. Arsyeja numër një për meshkujt pse nuk punojnë me orar

të plotë, ishte mungesa e një pune me orar të plotë. Ndërsa 19.2 % e personave të punësuar i përkiste kategorisë së punësimit të paqëndrueshëm. Kjo do të thotë se ata ose janë të punësuar në biznesin e tyre (punëtorë për llogari vetanake), ose kontribuojnë në një biznes familjar (të paguar ose të papaguar). Vetëm 28.4 % e personave të punësuar kishin kontratë të përhershme në punën e tyre kryesore, ndërkohë që 71.6 % kishin kontratë të përkohshme, pa dallime sinjifikante midis meshkujve dhe femrave. Personat, që kishin kontrata të përkohshme, u pyetën se pse kishin këtë lloj kontrate dhe 85.9 % e të intervistuarve raportuan se nuk kishte kontratë tjetër në dispozicion.

Pagat neto të shumicës së punonjësve ishin midis 400 € deri 500 € në muaj. Janë vërejtur dallime gjinore me 7.2 % më e lartë tek femrat se sa te meshkujt. (Ask, 2019)

Tabela 1. Klasifikimi i tregut të punës për popullsinë e Kosovës në bazë të raportit AFP-së



(Ask, 2019)

2.5 Ndikimi I Privatizimit në Papunësi

Është një indikator që mundë të jetë me ndikim mjaft të madhë në procesin e punësimit në Kosovë, kjo për faktin që mënyra se si ndërmarrjet janë privatizuar I'u kanë mundësuar privatizuesve që të ndërhyjnë në këtë proces pasi që shumë nga ndërmarrjet e privatizuara nuk kanë vazhduar të funksionojnë si në të kaluarën por I'u është ndryshuar destinimi i veprimtarisë që ato kanë pasur. (*Privatizimit*, 2019)

2.6 Raporti mes papunësisë dhe inflacionit

Inflacioni paraqet ngritjen e vazhdueshme të nivelit të përgjithshëm të çmimeve.

Papunësia dhe inflacioni paraqesin dy dukuri të padëshirueshme që çrregulojnë secila në formën e vet rrjedhat makroekonomike të çdo vendi ku ato janë të pranishme. Andaj, si objektiv kryesor i çdo politike aplikative makroekonomike duhet të jetë stabilizimi i çmimeve dhe punësimi i plotë. Pra, shteti me masa përkatëse të politikës ekonomike duhet ta luftojë si papunësinë ashtu edhe inflacionin, ngase të dy këto dukuri kanë interaksion dhe në masë të konsiderueshme çrregullojnë rrjedhat makroekonomike. Prandaj, për ta luftuar efektin negative të tyre bartësit (shteti) e politikës ekonomike duhet ta njohin shumë mirë raportin funksional dhe të ndërsjellë që ekziston midis papunësisë dhe inflacionit. Inflacioni nuk mund të eliminohet pa e rritur papunësinë të paktën për disa kohë dhe papunësia nuk mund të shkurtohet mbretas pa rrezikun e rritjes së infalcionit. Kjo është marrëdhënia bazë inverse (trade-off) dhe problem I politikës së stabilizimit.

Shkaktarët apo burimet e infalcionit janë të llojllojshme dhe të natyrave të ndryshme, por ndër më kryesorët janë: kriza ekonomike, përgatitja për luftë dhe vetë lufta, fatëkeqësitë elementare, ndërtimi dhe rindërtimi, investimet pa mbulesë, shpenzimet e mëdha të qeverisë-vështirësit buxhetore, rritja e shpenzimeve të prodhimit mbi produktivitetin e punës ekspansioni i politikës kreditore, ngritja e pagave mbi produktivitetin e punës, ndryshimi në

shpërndarjen e GNP, GDP dhe NNP, ashpërsimi I bilancit të pagesave-deficiti i bilancit të tregtisë së jashtme, humbjet në ekonomi etj.

Në vitin 1958, (*Phillips 1958*) konkludon grafikisht një lidhje të rëndësishme inverse midis ndryshimit në paga dhe normës së papunësisë. Ai tregoi se sa më i lartë është ndryshimi në paga aq më e ulët do të jetë norma e papunësisë dhe anasjelltas. Bazuar në konkluzionin deduktiv të Phillips-it, (*Samuelson, Soloë 1960*) gjejnë një marrëdhënie empirike midis normës së inflacionit dhe normës së papunësisë në SHBA. Kjo marrëdhënie është e ngjashme me gjetjet e Phillips-it, që ndryshimi pozitiv në normën e inflacionit do të shkaktojë një ndryshim negativ në normën e papunësisë dhe anasjelltas. (*Samuelson, Soloë 1960*) sugjerojnë se ndjekja e një ekspansioni monetar apo fiskal për të rritur inflacionin është një mënyrë efektive për të arritur, në këmbim, një normë më të ulët të papunësisë. Por, duke mbi ushtruar këtë masë mund të krijohet inflacion i tepërt, gjë që mund të rrezikojë stabilitetin makroekonomik të një vendi. Sipas (*M. Friedman 1977*) lidhja midis inflacionit dhe papunësisë ka kaluar nëpër tre hapa. Hapi i parë ka qenë pranimi i një —trade-off të qëndrueshëm apo i një lidhjeje inverse midis inflacionit dhe papunësisë (kurba e qëndrueshme e Philipsit). Hapi i dytë ka qenë paraqitja e pritjeve të inflacionit, si një variabël që ka ndryshuar lakoren afatshkurtër të Philipsit dhe normën natyrore të papunësisë, duke përcaktuar lakoren vertikale afatgjatë të Philipsit. Hapi i tretë është shkaktuar nga një fenomen empirik i një relacioni të dukshëm pozitiv midis inflacionit dhe papunësisë. (*Limani, 2002*)

2.7 Paga mujore neto

Duke marrë parasysh pagat në Kosovë si në sektorin privat ashtu edhe publik pagat neto të shumicës së punonjësve ishin midis 400 € deri 500 € në muaj. Janë vërejtur dallime gjinore me 7.2 % më e lartë te femrat se sa te meshkujt, gjithomnë duke u bazuar në bazë statistikave të nxjerrura nga ASK-ja edhe AFP-ja. (*Ask, 2019*)





Figura 3. Paga mujore neto për punonjësit sipas gjinisë

(Ask, 2019)

2.8 Punësimi sipas gjinisë

Nga e gjithë popullsia në moshë pune, 28.8% ishin të punësuar. Shkalla e punësimit ishte më e lartë për meshkuj se sa për femra: 45.3 % të meshkujve në moshë pune ishin të punësuar krahasuar me 12.3 % të femrave po ashtu në moshë pune.

Krahasuar me AFP-së 2017 në Kosovë, kemi rënie të shkallë së punësimit me 1.0 %, ku kjo rënie të meshkujt ishte 1.3 % përderisa të femrat kjo rënie është 0.4%.



Grafikoni 1. Papunësia sipas gjinisë

(Ask, 2019)


2.9 Personat joaktivë

Vëmendje e veçantë i është kushtuar përshkrimit dhe vlerësimit të popullsisë së punësuar dhe asaj të papunë, që së bashku përbëjnë Fuqinë Punëtore (ose personat ekonomikisht aktivë). Megjithatë, kategoria “joaktivë” është po aq e rëndësishme. Ndryshimet në shkallën e aktivitetit janë pjesë e rëndësishme e ndikimit të ofertës së punës në rritjen potenciale ekonomike. Kjo për shkak të numrit të madh të punëtorëve potencialë në mesin e persona ve aktualisht joaktivë.

Krahasuar me AFP-së e vitit 2018 në Kosovë, kemi rritje të shkallës së jo aktivitetit me 1.9%, ku kjo rritje te meshkujt ishte 2.0% përderisa te femrat kjo rritje ishte 1.4%.

Nga ky grafikoni është e qartë se pjesëmarrja më e madhe është në mesin e femrave se në

mesin e meshkujve: 81.6% e femrave ishin jo aktive në krahasim me 36.7% e meshkujve.



Grafikoni 2. Popullsia jo aktive

(Ask, 2019)

3 DEKLARIMI I PROBLEMIT

Gjatë hulumtimit, është parë se nuk ka shumë literaturë në lidhje me statistikat rreth papunësisë dhe faktorët që ndikojnë në të, për këtë arsye si rastë studiimi kamë marrë qytetin e Lipjanit për shkak qasjen më të lehtë në të dhëna primare.

Duke u nis nga fakti se viteve të fundit ka pas një rritje në hapjen e bizneseve të reja ne qytetin e Lipjanit atëherë kjo në fillim na lejon të mendojmë që ato duhet të ndikojnë në zbutjen e papunësisë në statistika reale duke krijuar vende të reja të punës, me deklarin punëtoreve të lidhur me kontrata pune mirpo se sa është ndikimi i tyre në zbutjen e shkallës së papunësisë do të diskutojmë ne pjesen e rezultateve të marra nga bizneset përkatëse që janë zgjedhur për tu përdour si rast studiimi.

Ndërsa për pytjen e dytë kërkimore fokusi ka qenë në shtresen e cila vetë punësohet ose punojnë në biznese familjare pa pagesë ndikimi i sajë në papunësinë në bazë të gjinisë, profesionit si dhe nivelit arsimor.

Në këtë punim si pyetje themelore kërkimore do të jetë:

A ndikon sektori privat në përqindje të papunësisë në qytetin e Lipjanit ?

H0: Sektori privat nuk ndikon në përqindje të papunësisë

H1: Sektori privat ndikon në përqindje të papunësisë

Pytjet tjera do te jenë, në bazë të përmbledhjes si dhe krahasimeve të statistikave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës:

A ndikon punësimi I paqëndrueshëm në përqindje të papunësisë ?

H0: Punësimi i paqëndrueshme nuk ndikon në përqindje të papunësisë

H1: Punësimi i paqëndrueshme ndikon në përqindje të papunësisë

4 METODOLGJIA

Në këtë kapitull paraqitet qasja hulumtuese, strategjia hulumtuese dhe procesimi i të dhënave nga mbledhja e të dhënave deri të analiza e tyre.

Metodologjia e kërkimit përfshin mbledhjen e të dhënave nga metoda të ndryshme kërkimore dhe përpilimin e bazave të të dhënave në mënyrë që të analizohen të dhënat dhe të arrihet ndërtim i duhur i hulumtues.

Duke u bazuar në pyetjen hulumtuese, është zgjedhur të përdoret metoda kualitative si qasje hulumtuese. Metoda kualitative është zgjedhur për arsye hulumtime dhe studime të mëhershme vetëm pjesërisht kanë shpejguar pyetjen hulumtuese, ndërsa unë i jamë qasur në menyre direkte problemit në këtë rastë ku është parashtruar përmes pyetjes hulumtues duke e shfaqë atë me kapacitet e mija dhe duke paraqit fenomene komplekse që duhet të organizohen dhe të analizohen më tutje. Për përfundimin e punimit tim duke a pas parasysh edhe peshën e temës që kamë zgjedhur janë përdorur të dhëna primare, sekondare dhe të dhëna të statistikore.

Metoda e mbledhjes së të dhënave për të realizuar hipotezen e këtij punimi është bërë përmes intervistes së drejtëpërdrejtë si dhe pyetësorët, ku është bërë intervistimi i responentëve për të marrë opinionet e tyre, shqetësimet dhe njohurit e tyre për çështjen e caktuar. Do të intervistohen gjithsej 4 kompani: Stullca Construction (Industria e ndertimtarisë), Room Lounge (Industria e Hotelerisë), Teos-E (Industria e përpunimit qumshtit) dhe Koral Dairy (Industria e përpunimit qumshtit). Intervista përfshin mbledhjen e të dhënave nga përgjigjet e responentëve, klasifikimin e të dhënave, analizimin e tyre, krahasimin e rezultateve dhe në fund arrijen e konkluzioneve kryesore që do të ndihmojnë në vërtetimin e hipotezës.

Intervistimi do të bëhet në një afat kohor prej 15 ditëve varësisht nga gatishmëria e menaxherëve të kompanisë për të pranur takimin, pastaj do të bëhet analizimi i përgjigjeve dhe interpretimi i tyre.

Ndërsa të dhënat sekondare vijnë në bazë të akomodimit të dhënave përmes librave ekonomik, ligjeratave të profesorëve të ndryshëm, pastaj janë të dhënat statistikore të cilat janë marrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës ku është bërë analiza e tyre dhe me përpunimin dhe krahsimet e bëra të shfaqura nga të dhënat e ASK-së do të paraqes edhe pytjet tjera hulumtues duke marrë parasysh natyrën e punimit e cila është mjaftë e gjerë.

5 REZULTATET

Në këtë kapitull diskutohen rezultatet e fituara nga literatura e shqyrtuar dhe rezultatet empirike nga pyetësi për pyetjet konkrete. Gjithashtu, paraqiten diskutimet kryesore të pyetjeve hulumtuese, duke përfshirë edhe paraqitje përmes tabelave dhe grafikëve.

5.1 Historiku I Kompanive (Resultati A)

Stullca Construction

Stullca Construction është kompani ndërtimore e themeluar në vitin 2015. Me një përvojë dhe staf të kualifikuar, kompania Stullca renditet si një ndër kompanitë më të suksesshme. Projektet të cilat i ka ndërtuar Kompania Stullca nëpër Kosovë përfshijnë objekte të ndryshme si: Banesa Kolektive, Shtëpi Banimi. Me një besim të madh, me teknologji të sofistikuar dhe cilësi shumë të mirë të ndërtimit në fusha të ndryshme, mundohen që sa më tepër t'i përmbahen objektivave, vizionit dhe misionit për punë sa më të suksesshme dhe kualitativ

Room Lounge

Room Lounge është lounge me finesë dhe zgjedhje të vecantë për momente të vecanta, familjare dhe shoqërore.

Me traditë shumëvjeçare duke funksionu në qytetin e Lipjanit që nga viti 2007, ku gjindet në një lokacion mjaftë të mirë në qendër të qytetit me shërbime të njohura me cilësi dhe kualitet të lartë. Room i'u ofron klientëve kuzhinë me ushqime sipas shijes dhe llojeve të ndryshme, duke përfshirë tryeza me shije dhe kombinim lokal dhe ndërkombëtar.

Duke i'u përshtatur shijeve dhe klientelës Room Lounge poashtu ofronë lloje të ndryshme të pijeve, vendore dhe ndërkombëtare, me verëra të zgjedhura dhe me shije.

TEOS-E

TEOS-E është fabrika për përpunimin e qumshtit dhe grumbullimin e qumshtit që furnizohet nga fermer të ndryshëm të Kosovës, fabrika operon në treg që nga viti 2016 ku është e ndërtuar me lokacion në fshatin Sllovi të Lipjanit 12km nga qyteti.

TEOS-E ka një numër të madhë të produkteve të cilat i prodhonë nëpërmjet përpunimit të qumshtit 12 produkte të ndryshme, ku përfshijnë rreth 25 përmasa të ndryshme varësishtë nga ambalazhi. TEOS-E është fabrik në rritje e siper dhe pritshmërit e tyre janë që të përfshijnë pjes më të madhe të tregut

Përmes hulumtimit të bërë në kompanitë e caktuara, për punëtorët total dhe numri i tyre të cilët janë të lidhur me kontrata pune dhe aktivitetet e tyre, janë identifikuar të dhëna që kanë ndikim të madh në shkallen e përqindjes së papunësisë. Arsytet se përse këto dhëna në lidhje me numrin e të punësuarve me kontrata pune cilësohen si më të rëndësishmet janë sepse ato ndikojnë më së shumti në mos zvoglimin e përqindjes së papunësisë, ku realisht personat e caktuar janë të zënë me punë mirpo në bazë të ligjeve të Kosovës ata nuk figurojn në listen e të punësuarve.

Koral Dairy

Familja e bizneseve Koral tanimë është një ndër emërat më të njohur në tregjet e rajonit sa I përket zhvillimit të tregtisë së lirë dhe prodhimit të qindra produkteve të ndryshme ushqimore dhe jo ushqimore. Koral është themeluar në vitin 1968 me fokus të vecantë në tregtimin e metaleve të vlefshme si ari dhe argjendi. Gjatë fillimit të viteve të 90-ta, për shkak të situatës së vështirë politike dhe mungesës së shumë produkteve ushqimore në tregun Kosovar kjo kompani filloi të merrej me tregtinë e produkteve ushqimore esenciale. Që nga ajo kohë e deri në ditët e sotme, Koral njihet si kompania më e madhe në Kosovë për sa i përket produkteve ushqimore. Pas luftës Korali filloi zgjerimin e operimeve të saj në fushën e


prodhimit dhe zhvillimit ekonomik. Ndershmëria e të bërit biznes dhe produktet më kualitative në treg ishin shtyllat kryesore që nuk e penguan këtë kompani të zgjerohej çdo herë e më shumë. Tani Koral është një ndër eksportuesit më të mëdhenjë në rajon të produkteve ushqimore. Pas afro 6 dekadave në biznes, në Maj të vitit 2012, Koral hapi edhe fabrikën për prodhimin dhe përpunimin e produkteve të qumështit. Duke punuar pa ndalur në inkurajimin dhe vetëdijësimin e fermerëve rreth rëndësisë së bujqësisë, Qumshështorja Koral u bë lider i grumbullimit të qumështit në rajonin e Kosovës për një kohë shumë të shkurtër. Misioni i kësaj kompanie është plotësimi maksimal i nevojave të tregut duke pasur inovacion, zhvillim të kapitalit njerëzor dhe investim paralel në ndryshimet teknologjike. Ndërsa, vizioni ka të bëjë me zhvillimin e prodhimeve të cilat kanë bilanc negativë në nivel nacional, ku importi është më i madh se eksporti. Pra Koral Dairy tash e 7 vite operon në tregun e Kosovës me prodhimin e produkteve të qumështit ku edhe renditet si top kompanitë në këtë sektor, në vete përmban dikun rreth 40 lloje të produkteve që prodhon dhe vlen të theksohet se është e vetmja fabrikë e përpunimit të qumështit në Kosovë që prodhon Edamer, Kaçkavall dhe Trapist.

Tabela 2. Paraqitja tabelare e numrit të punëtorëve në kompanitë përkatëse

Kompanitë	Numri I të punësuarve	Numri I punëtorëve të lidhur me kontrata pune	Meshkuj	Femra	Sezonal	Pronarë
Stullca Construction	25	20	24	1	5	1
Room Lounge	14	5	14	x	x	4
TEOS-E	16	13	6	10	x	1
Koral Dairy	70	70	55	15	x	5


(Të dhëna primare)

Më lartë kemi paraqitur në menyrë përmbledhëse disa statistika për kompanitë më lartë, rreth numrit të punëtoreve dhe të pronarëve, të dhënat janë primare të vizituara nga unë.



Grafikoni 3. Paraqitja e profileve të operimit të kompanive
(Të dhëna primare)


Në fillimin e këtij pyetësoi janë marrë informatat për profilin e kompanive ku këtu në grafikon është paraqitur në mënyr sa për të përkufizuar ndërsa më lartë niheri më aktivitetet dhe veprimtarinë e tyre që ato i kryejnë dhe me historikun e tyre.



Grafikoni 4. Paraqitja vjetore e operimit në tregun Kosovar të Kompanive përkatëse
(Të dhëna primare)


Në baze rezultateve të arritura nga operimi i këtyre kompanive në tregun Kosovar shohim se Room Lounge është ajo e cila ushtron veprimtarinë e vetë tashë e 12 vite pastaj pason Koral Dairy me 7 vite, Stullca Construction 4 vite dhe Teos-E me 3 vite.

Në cilat kohë keni numrin e të punësuarve më të madhë?




Grafikoni 5. Paraqitja e operimit në tregun Kosovar të Kompanive përkatëse
(Të dhëna primare)

Përmes këtij grafikoni e vertetojmë edhe gjithë peshën e punësimit sezonal që kemi folur më lartë duke pasur parasyshë se Kosova gjatë veres ka numer të konsiderushëm të mergimtareve që vijnë këtë e vrejme edhe përmes këtij pyetësi ku kompanit përkatëse janë shprehur se numri i të punësuarve është më i madhë në kohën e stinës së verës.




Grafikoni 6. Moshë e punëtorëve të interesuar për punë dhe kuadri tyre
(Të dhëna primare)

Duke u bazuar në rezultate e fituara shohim që dominon moshë 18-28 vjeçare në kënd të përgjithshëm, gjë cila e verteton që vendi i Kosovës ka fuqi punëtorë në moshë të re e cila është e angazhuar për të punuar, zakonisht janë ata të kualifikuar më shkollë të mesme ndërsa ka edhe prej tyre që kanë diplome universitare mirpo nuk kanë mundur ta gjejnë veten në profesionin e tyre dhe u është dashur tu drejtohen kompanive përkatëse



Grafikoni 7. Punëtori është Kosto apo Burim që krijon vlerë
(Të dhëna primare)

Nga grafikoni më lartë janë marrë në pyetje kompanitë përkatëse në lidhje se a e trajtojnë punëtorin si kosto apo e shohin si burim i cili krijonë vlerë, ata janë përgjigjur në mënyr që punëtorin e shohin si burim që krijonë vlerë më shume se sa si kosto.



Grafikoni 8. Numri i punëtorëve të lidhur me kontrata pune

(Të dhëna primare)

Theksojmë që kjo pyetje do të përdoret vetëm për rezultate të punimit të diplomes, informatat do të jenë anonime.

Nga grafikoni më lartë janë paraqitur të dhënat në lidhje me numrin e punëtorëve të lidhur me kontrata pune duke ditur që tek historiku i kompanive në menyrë tabelare janë paraqitur edhe numri total që kanë si të punësuar këto kompani dhe të dhënat dalin se kompania, Stullca Construction nga 25 të punësuar 20 prej tyre janë të lidhur me kontrata pune, Room Lounge nga 14 të punësuar 5 prej tyre janë me kontrata pune, Teos-E nga 16 të punësuar 13 prej tyre janë me kontrata pune dhe në fundë kompania Koral Dairy nga 70 total të punësuar të gjithë i ka të lidhur me kontrat pune.

Tek kjo pyetje është pesha më e madhe e punimit tim ku jamë mbështetur nga biseda të ndryshme me miqë dhe kolegë që si është e mundur një shkallë kaqë e madhe e papunësisë në Kosovë, andaj shohim se ndikim të madhë në shkallë të papunësisë luajn bizneset


private të cilat nuk deklarojnë punëtorët e tyre dhe kjo automatikishtë dërgon në numer negativë në lidhje me numrin real të të punësuarëve në Kosovë.



Grafikoni 9. Selektimi i punëtorëve
(Të dhëna primare)

Lidhur me sistemin për të selektuar punëtorë potencial kompanitë përkatëse janë përgjegjës në atë mënyrë që ato hapin konkurs pune tashmë nëpër portale pune që janë në vendin tonë dhe pastaj personat përgjegjës i zgjedhin ata në bazë kriterit të kërkuar nga kompania për kushtet e pozitës së punës, mirpo kemi edhe përgjigje të tipit që selektimi i punëtorëve mirret edhe duke u referuar nga punëtorët tjerë.


Ciles gjini I takojn punëtorët tuaj, dhe shkruani numrin e saktë?



Grafikoni 10. Gjinija e punëtoreve

(Të dhëna primare)

Lidhur me atë se ciles gjini i takojnë punëtorët më lartë shohim se varësishtë nga profili i kompanisë kemi edhe numrin e të punësuarëve në bazë të gjinisë ku shohim se Koral Dairy ka të punësuar 15 femra dhe 55 meshkuj, Teos-E ka të punësuar 10 femra dhe 6 meshkuj, Room Lounge ka të punësuar 14 meshkuj dhe asnjë femer dhe në fund Stullca Consturction ka të punësuar 1 femer dhe 24 meshkuj.



Grafikoni 11. Kualifikim i punëtorve
(Të dhëna primare)

Lidhur me kualifikim e punëtorëve shohim në përqindje të shprehur më lartë mendimin e kompanive përkatëse ku Koral Dairy 95%, Teso-E 60%, Room Lounge 75%, Stullca Construction 98%.

Përgjatë analizimit të këtyre pyetjeve dhe duke u bazuar në përgjigjet e kompanive përkatëse, i gjithë ky rezultat me pyetjen “A ndikon sektori privat në përqindje të papunësisë në qytetin e Lipjanit?” rezulton në përputhje me hipotezën.

H1- Sektori privat ndikon në përqindje të papunësisë.

“Të gjitha të dhënat e paraqitura në grafikun janë primare të cilat i kamë nxjerr vetë personalisht me personat udhëheqës të kompanive përkatëse”

5.2 Punësimi i paqëndrueshëm (Resultati B)

A ndikon punësimi I paqëndrueshëm në përqindje të papunësisë?

H0: Punësimi i paqëndrueshëm nuk ndikon në përqindje të papunësisë

H1: Punësimi i paqëndrueshëm ndikon në përqindje të papunësisë

Tabela 3. Punësimi i paqëndrueshëm sipas gjinisë

Kosovë Punësimi i Paqëndrueshëm (në mijëra)	
Meshkuj	54.9
Femra	12.0
Total	66.9
Kosovë Punësimi i Paqëndrueshëm (në %)	
Meshkuj	20.2
Femra	15.9
Total	19.2

(Ask, 2019)

Tabela 4. Punësimi i paqëndrueshëm sipas profesionit dhe gjinisë

Kosove	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Të vetëpunësuar pa punonjës të tjerë (%)			
Ligjvënës, zyrtarë dhe menaxherë të lartë	3.3	0.0	2.7
Profesionistë	5.4	4.3	5.2
Teknikë dhe profesione të lidhura me ta	2.9	1.1	2.6
Nëpunës	1.5	0.0	1.3
Punëtorë shërbyes dhe shitës në dyqane dhe tregje	27.4	24.0	26.8
Punëtorë të kualifikuar në bujqësi dhe peshkatari	8.8	0.8	7.5
Punëtorë zejtarie dhe të ngjajshëm me ta	18.3	60.8	25.4
Operatorë fabrikash dh makinerish dhe montues	9.6	2.8	8.4
Profesione elementare	22.8	6.1	20.0
Gjithsej	100	100	100
Punëtorë familjarë të papaguar (%)			
Ligjvënës, zyrtarë dhe menaxherë të lartë	0.7	4.6	1.5
Profesionistë	2.9	3.6	3.1
Teknikë dhe profesione të lidhura me ta	0.6	4.9	1.5
Nëpunës	0.0	3.0	0.6
Punëtorë shërbyes dhe shitës në dyqane dhe tregje	33.5	46.9	36.3
Punëtorë të kualifikuar në bujqësi dhe peshkatari	16.7	11.5	15.6
Punëtorë zejtarie dhe të ngjajshëm me ta	21.0	6.4	17.9
Operatorë fabrikash dh makinerish dhe montues	4.2	0.0	3.3
Profesione elementare	20.3	19.2	20.1
Gjithsej	100	100	100

(Ask, 2019)

Tabela 5. Punësimi i paqëndrueshëm sipas nivelit arsimor dhe gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Të vetëpunësuar pa punonjës të tjerë (%)			
Pa shkollë	0.7	5.3	1.5
Fillor	27.5	47.4	30.8
Arsim i mesëm profesional	30.7	29.8	30.6
Shkollë e mesme gjimnazi	33.0	6.6	28.6
Terciar	8.1	10.8	8.5
Gjithsej	100	100	100
Punëtorë familjarë të papaguar (%)			
Pa shkollë	0.0	0.0	0.0
Fillor	13.3	25.8	5.9
Arsim i mesëm profesional	44.5	42.4	44.0
Shkollë e mesme gjimnazi	28.6	24.1	27.6
Terciar	13.7	7.8	12.4
Gjithsej	100	100	100

(Ask, 2019)

Përveç shkallës së ulët të punësimit në Kosovë, 19.2 % e personave të punësuar punonin në vende pune të paqëndrueshme. Punëtorët në punë të paqëndrueshme janë ose persona të vetëpunësuar pa punonjës, ose ata që punojnë pa pagesë në një biznes familjar. Këto dy grupe punëtorësh kanë gjasat më të ulta të kenë një marrëveshje formale pune në krahasim me punëtorët me pagesë dhe rrogë. Meshkujt kanë më shumë gjasa të mbajnë punë të tilla të paqëndrueshme (20.2 %) e meshkujve të punësuar krahasuar me 15.9% të femrave të punësuar). Shprehur në numra absolutë, 66,872 persona nga 347,550 të punësuar i përkasin kategorisë së punësimit të paqëndrueshëm. Të punësuarit në fusha profesionale kanë më pak

gjasa të jenë të punësuar në punë të paqëndrueshme, si dhe personat me nivel të lartë arsimimi

.

Në bazë rezultateve të gjetura shohim se për pytjen dytë kërkimore vlen hipoteza H1

H1- Punësimi i paqëndrueshme ndikon në përqindje të papunësisë

6 DISKUTIME DHE PËRFUNDIME

Në këtë kapitull janë përmbledhur pikat kryesore nga i gjithë punimi për të shpjeguar më mirë pyetjen hulumtuese.

Në këtë punim janë paraqitur probleme të shumta rreth papunësisë në Kosovë po ashtu janë shtjelluar edhe vetë definicionin e papunësisë ku nihet si “sëmundje e rëndë” makroekonomike dhe i punësuar cilësohet ai i cili është në marrdhënie pune ashtu si e sheh ligji që punon me normë të caktuar të orëve të punës në këmbim të një shume të caktuar që njihet si pagë, qoftë edhe kur mungon përkohësishtë në punë përshkak se është i sëmurë, është në pushime ose në grevë. Ndërsa të pa punë ishin të gjithë ata persona që nuk ishin në marrdhënie pune mirpo kërkojnë punë në mënyrë aktive.

Diskutuam se të papunët përveq se janë barrë financiare për qeverinë ata mund të jepen edhe pas dukurive negative në shoqëri p.sh rritja e shkallës së kriminalitetit në vend. Popullsia në moshë pune bënin pjesë nga 16-65 vjeç. Kemi folur për llojet e papunësisë ku kemi atë të fërkimit që rezulton nga levizja e njerzve prej një pune në tjetrën ose nga një regjion në tjetrin .më pas kemi atë strukturore shfaqet atëherë kur oferta për punë dhe kërkesa nuk përputhen ku bënin pjesë imobiliteti profesional që nënkupton mungesen e gatishmërisë të lënjes së profesionëve të vjetra dhe përvetësimin e atyre të reja po ashtu kemi edhe imobilitetin gjeografik që nënkupton vështirsitë lidhur me largimin nga regjionet depresive për arsye sociale, ekonomike. Më pas kemi llojin e papunësisë ciklike rezulton kur kërkesa për punë është e ulët dhe në fund folëm edhe për atë sezonale lidhet me karakter stinor si shembull mundemi ta marrim industrinë e ndërtimit, turizmin, shërbimet e ndryshme.

Gjatë këtij hulumtimi erdhëm deri tek statistikat e shkallës së papunësisë në raport me numrin e popullësisë në Kosovë I cili është 1.739.825 me përqindje në shkallë të papunësisë me 30.07% nga rezultatet e fundit të ASK-së. Pagat neto për dallim nga statistikat tjera të dhëna

e verejtëm që duke përfshi sektorin publik dhe privat pagat e shumicës së punonjësve ishin midis 400€ dhe 500€.

Së fundmi kemi pytet kërkimore ato të cilat më kanë shyrë të grumbullojë dhe përpunoj të dhëna, rezultatet e të cilave janë paraqitur në pjesën përkatëse.

6.1 Rekomandimet

Gjatë këtij punimi u njohëm me problem të shumta që e shkaktojnë papunësinë dhe efektet e saj në shoqëri si dhe u shpalosen edhe shumë statistika rrethë sajë. Duke pasur parasyshë gjithmonë që Kosova është vetëm një shtet i cili ka dalë qe 20 vite nga lufta e cila ka qenë e shkatërruar plotësishtë e dim që ka edhe ngecje të mëdha në shumë sfera të ndryshme ti quajmë shtetore mirpo në punimin tim, tem diskutimi ka qenë papunësia dhe ngecja në sektorin privat.

Gjithmonë duke u nisë me numrin e banorëve në Kosovë si dhe vendet e hapura të punës e dimë që Kosova ka nevoj për të krijuar kushte investitoreve të huaj apo atyre vendas për të hap fabrika të cilat krijojnë vende të reja pune, mirpo nga këndëveshtrimi i punimit shohim që përveq se duhet të hapen fabrika të reja nevojitet edhe angazhimi i inspektoreve në teren për të kontrolluar të gjitha bizneset mbi deklarin e punëtoreve sepse nga rezultatet e para më lartë shohim se kompanit të cilat janë marrë në rastin e studimit kanë punëtorë të pa deklaruar që do të thotë nuk janë të lidhur në menyrë ligjore me kontrata pune pastaj ata figurojnë si të “papunë”.

Rekomandimi im është vetem ndezja e motoreve për të gjithë inspektoret përgjegjës per shikimin e procesit të punës, deklarimit të punëtoreve nëper sektor privat si dhe përmisimi i kushteve të punës në të.

7 REFERENCAT

- Ask, A. i. S. t. K., 2019. *Agjencioni i Statistikave të Kosovës ASK*. [Online]
Available at: <http://ask.rks-gov.net/>
- Limani, P. M., 2002. Hyrje në Ekonomi. In: *Hyrje në Ekonomi*. Prishtinë: Shtypshkronja "ELKOS" Prishtinë, p. 292. Online, I., 2019. *Indeks Online*. [Online]
Available at: <https://indeksonline.net/papunesia-ne-kosove-me-e-larte-se-sa-e-tregojne-statistikat/>
- Privatizimit, A. K. e., 2019. *Agjencia Kosovare e Privatizimit*. [Online]
Available at: <http://www.pak-ks.org/>
- Veseli, S., 2019. *SCRIBD*. [Online]
Available at: <https://www.scribd.com/document/33883062/MAKROEKONOMI-Infacioni-Dhe-Papunesia>
- Zeqiri, N., 2016. Papunësia. In: *Papunësia - Ligjeratë e autorizuar*. Prishtinë: 6, p. 20.

8 APPENDIXES

Pyetësor:



Kolegji UBT

Drejtimi: Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Ky pyetësor ka për qëllim mbledhjen e informatave në lidhje me papunësinë në Kosovë dhe deklarinimin e punëtorëve nëper sektor privat të lidhur me kontrata pune, të dhënat e të cilave do të na ndihmojnë të mbledhim informacione në lidhje me realizimin e këtij pyetsori. Përgjigjet tuaja në këtë pyetësor do të mbesin anonime dhe nuk do të shfrytëzohen për qëllime tjera, përveq këtij punimi hulumtues.

Faleminderit për përkrahjen tuaj.

Pyetësori

Të dhënat për kompaninë

1. Emri dhe Mbiemri i intervistuesit

2. Emri i kompanisë

3. Në cilin sektor operon kompania juaj ?

Industrinë e Hotelerisë

Industria e ndërtimit

Industrinë e pijeve

Industrinë e përpunimit qumshtit

4. Sa vite operon kompania juaj në këtë industri?

5. Në cilat kohë keni numrin e të punësuarve më të madhë?

Verë

Dimer

Vjeshtë

6. Cila moshë shpreh më shumë interesim për punë, dhe cili kuader i takojnë ?

Mosha 18-28

Mosha 28-40

Mosha 40-65

7. A i trajton kompania juaj punëtorët si një lloj i kostos ose burim që krijon vlerë?

Kosto

Burim që krijon vlerë

8. Sa është numri i punëtoreve tuaj të lidhur me kontrata pune?

Theksojmë që kjo pyetje do të përdoret vetëm për rezultate të punimit të diplomes, informatat do të jenë anonime.

7. A përdorni ndonjë sistem për të selektuar punëtorët potencial?

Po

Jo

8. Ciles gjini I takojn punëtorët tuaj, dhe shkruani numrin e saktë?

M

F

9. Sa mendoni që punëtorët e sektorit tuaj janë të kualifikuar për punën e lidhur me ju?

1 2 3 4 5

Faleminderit për kohën dhe ndihmën tuaj.